

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Një ankesë kundër: Policia e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i prokurimit	214/30400-25-8322-2-1-1
--------------------	-------------------------

**Sa i përket tenderit për: Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se**

**(Ri- vlerësimi pas Vendimit të PSH Nr. OSHP: 2025/1248 i datës 09.02.2026)**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**Emri i Kompanisë: "Beni Dona Plast: SH.P.K**


**Adresa : Lagja Ulpian, Rruga Imzot Nike Prelaj , Prishtine**

**Numri Telefonit: 044-508-507**

**Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Fadil Paçarada**

**Adresa elektronike: [prokurimi.zyra@gmail.com](mailto:prokurimi.zyra@gmail.com)**

**Data e parashtrimit të ankesës: 19.03.2026**

Nënshkrimi dhe vula: 

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)/(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)/(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 12.09.2025
2. Afati për dorëzim të tenderit: 24.11.2025
3. Kriteret e dhënies: Çmimi më i ulët i peshuar
4. B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim Gabimi:24.09.2025
5. B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim Gabimi:14.11.2025
6. Kërkesë për Rishqyrtim – Isuf Musliu B.I: 03.10.2025
7. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit: 17.09.2025
8. Vendim mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim OE: Isuf Musliu B.I: 23.09.2025
9. Ankesa në OSHP, Nr. 2025/0984 Isuf Musliu B.I : 03.10.2025
10. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit:03.10.2025
11. Raporti i Ekspertit Shqyrtues për Ekspertizën 2025/0984:15.10.2025
12. Vendimi i OSHP-se nr. OSHP: 2025/0984:
13. Kërkesë për Rishqyrtim Beni Dona Plast SH.P.K: 19.11.2025
14. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit: 19.11.2025
15. Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim Beni Dona Plast SH.P.K: 19.11.2025
16. Procesverbali i Hapjes së Ofertave: 24.11.2025
17. B47- Letra Standarde e Kërkesë për Sqarimet e Tenderit:26.11.2025
18. Përgjigjja në kërkesën e AK për sqarime të Tenderit, Beni Dona Plast SH.P.K: 01.12.2025;
19. Raporti i Vlerësimit të ofertave: 02.12.2025
20. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 02.12.2025
21. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 02.12.2025
22. Kërkesë për qasje në dokumentet e tenderit- E-Prokurimi: 03.12.2025

23. Pranimi i dokumenteve të Tenderit nga AK ne CD ne lokalet e AK- Policisë së Kosovës: 04.12.2025
24. Kërkese për Rishqyrtim: 08.12.2025
25. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 10.12.2025
26. Ankesa ne Organin Shqyrtues të Prokurimit nr. 2025/1248 :19.12.2025
27. Vendimi i Panelit Shqyrtues, OSHP/2025/1248 :09.02.2026
28. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 27.02.2026
29. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që ka të shënuar datën 25.02.2026 ndërsa në Platformën e E-Prokurimit është publikuar me 27.02.2026
30. Kërkese për qasje në dokumentet e tenderit- E-Prokurimi:02.03.2026
31. Pranimi i Raportit të Rivlerësimit të ofertave në CD në lokalet e AK- Policisë së Kosovës: 03.03.2026
32. Kontratën e nënshkruar me AK-Policinë e Kosovës me numër të Prokurimit: 214/30400-25-11240-215 - Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se: 31.12.2025
33. Kërkese për Rishqyrtim: 04.03.2026
34. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 09.03.2026

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Hapja e ofertave është bere me datën 24.11.2025 në ora 14:00

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës pas Rivlerësimit të ofertave pas Vendimit të PSH Nr. **OSHP: 2025/1248** të datës **09.02.2026** , me datën **27.02.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar të cilat kane të shënuar datën **25.02.2026** , ndërsa në Platformën e E-Prokurimit janë publikuar me datën **27.02.2026**

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Me datën 04.03.2026 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës. Me datën 09.03.2026 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anullim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

Shkeljet e dispozitave - Rregullores 02/2024 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024), janë:

- Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit;
- Neni 97 – Shkeljet e Renda , paragrafi (h)- Mos respektimi i vendimit të OSHP-së Nr. OSHP/2025/1248 të datës 09.02.2026

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës pas Ri- vlerësimit të ofertave pas Vendimit të PSH Nr. **OSHP: 2025/1248** të datës **09.02.2026** , me datën **27.02.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar të cilat kane të shënuar datën **25.02.2026** , ndërsa në Platformën e E-Prokurimit janë publikuar me datën **27.02.2026**

Në Formularin B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka shënuar:

**“Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit në mungese të një oferte të përgjegjshme”.**

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë tone që ka të shënuar datën **25.02.2026** , ndërsa në Platformën e E-Prokurimit AK e ka publikuar me datën **27.02.2026**

**ka shënuar, citojmë:**

**“ OE është i papërgjegjshëm për pikat ne vijim:**

**OE ka ofruar çmime të cilat janë me të larta nga çmimet reale të tregut.**

- **Komisioni i rivlerësimit ka kërkuar te behet hulumtimi i tregut dhe nga hulumtimi i tregut pas vendimit te OSHP rezulton se OE ka ofertuar me çmime shume here me te larta se sa ato real ne treg, ndaj duke ju referuar nenit 4.1 pikës C të rregullore nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik e cila thotë gjate administrimit te procedurave te prokurimit, Autoriteti Kontraktues do te ketë obligimet në vijim: sigurohet qe çmimi i kontraktuar nuk është me i larte se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shume here me te larta se sa çmimet reale te tregut, duke ju referuar ofertës financiare OE ka ofruar me çmime shume here me te larta për te gjithë artikujt se sa vlera reale e tregut dhe te planifikuara nga ana e AK.**
- **Duke ju referuar edhe interpretimit te KRPP AK ne harmoni te plote me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës se pare te vlerësimit mbi çmimet shume here me te larta se sa ato reale ne treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri te formimi i këtyre çmimeve.” përfundon citati.**

Me datën **02.03.2026** përmes Platformës së E-prokurimit – Letrat Standarde, kemi bere kërkesë për qasje në dokumente e tenderit.

Me datën **03.03.2026** kemi qene ne qasje të dokumenteve të tenderit në lokalet e AK – Policisë së Kosovës. Nga Zyrtaret e Prokurimit të AK kemi pranuar në **CD** Raportin e Rivlerësimit te ofertave

Në kërkesën tone për qasje të dokumenteve të tenderit të datës **02.03.2026 përveç tjerash** kemi kërkuar që të kemi qasje edhe në **Dokumentet që dëshmojnë hulumtimin e çmimeve të tregut të bere nga zyrtaret e Autoritetit Kontraktues.**

Zyrtaret e Prokurimit të AK, dokumentet për hulumtimin e çmimeve të tregut të bere nga zyrtaret e Autoritetit Kontraktues, vetëm na i kane prezantuar por nuk na është dhëne asnjë dokument - dëshmi të këtij hulumtimi të tregut.

Të pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **27.02.2026** për anulim të aktivitetit të prokurimit, kompania jone Beni Dona Plast SH.P.K me datën **04.03.2026** kemi dërguar të Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës Kërkesën për Rishqyrtim. Së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim kemi dërguar të Autoriteti Kontraktues dëshmi të besueshme për çmimet aktuale të tregut për artikujt ushqimor që përbejnë **“pakot”** që AK-Policia e Kosovës ka kërkuara që të furnizohet.

Me datën **09.03.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues **për refuzim të kërkesës ton për rishqyrtim.** Në këtë vendim për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim si arsyeje të refuzimit të kërkesës tone AK ka shënuar së çmimet për njësi të artikujve me të cilat kemi ofertuar janë çmime me të larta, **par tani ne vend të çmimeve të planifikuara** nga hartuesit e specifikave teknike tani i referohet **çmimeve të hulumtimit të tregut** nga zyrtaret e AK pas vendimit të OSHP-së. Edhe tani AK nuk kane **ofruar asnjë dëshmi për çmimet e hulumtimit të tregut të artikujve ushqimore për vetëm ja ka bashkangjitur një tabelë të çmimeve pa sqaruar burimin e këtyre të dhënave së në cilat markete apo kompani kane bere hulumtimin e çmimeve.**

Bazuar në të dhënat që AK ka shënuar në vendimin për refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim – përqindjet e tejkalimit të çmimeve të hulumtimit të tregut pas vendimit të OSHP-së krahasuar më çmimet e ofertës tone shihet së ndryshimet e çmimeve të shprehura në përqindje janë shume të vogla ndërsa në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që kemi pranuar më datën **27.02.2026** ka shënuar së **“Komisioni i rivlerësimit ka kërkuar të behet hulumtimi i tregut dhe nga hulumtimi i tregut pas vendimit të OSHP rezulton se OE ka ofertuar me çmime shume here me te larta së sa ato real ne treg”**

Ky konstatim i komisionit të rivlerësimit të ofertave është jo profesional, tendencioz për faktin së asnjë nga çmimet e pakove me të cilat kemi ofertuar krahasuar me çmimet e hulumtimit të tregut asnjë prej tyre nuk është **“shume here me i larte”** ashtu siç pretendon AK për faktin së shume here me i larte do të thotë mbi 200 % e me larte.

Pretendimi ankimor - shkelje e nenit 59 dhe nenit 62 të LPP si dhe Shkeljet e nenti 40, nenit 43 dhe nenit 97, paragrafi (h)- të Rregullores 02/2024 për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues -PK prape ju ka referuar kërkesës për sqarime gjate vlerësimit të pare Konstatimi i AK “ së ne harmoni të plote me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës së pare të vlerësimit mbi çmimet shume here me te larta se sa ato reale në treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri të formimi i këtyre çmimeve” nuk qëndron për faktin bazuar në legjislacionin e prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës zbërthimi i elementeve të përbërjes së çmimeve behet vetëm në rastet kur Autoritetet Kontraktuese dërgojnë të Operatorët Ekonomik, Formularin B41- Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, por kurrsesi kur Autoriteti Kontraktues konsideron së çmimet me të cilat ka ofertuar Operatori Ekonomik janë çmime të larta. Me gjithat duke pare tendencën e Autoritetit Kontraktues për të na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit kompania jone me datën 01.12.2025 përmes Platformës së E-Prokurimit kemi dërguar Përgjigjen dhe sqarimet që i ka kërkuar AK. Në këtë përgjigje i kemi zbërthyer të gjitha çmimet e pakove për të gjithë artikujt që përbejnë pakot të cilat AK i ka shënuar në Listën e Përshkrimit të Çmimeve dhe kemi sqaruar edhe për elementet tjera që ndikojnë në kostot e çmimit të pakove.

Gjithashtu së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim që kemi dërguar të AK-Policia e Kosovës kemi dërguar edhe dëshmitë e çmimeve te ETC, VIVA FRESH , Meny - Nazi Restorant, Me Luge, dhe kupon fiskal për të dëshmuar së cilat janë çmimet aktuale te tregut.

Autoriteti Kontraktues fare nuk është bazuar as në sqarimet tona kur vepruam sipas kërkesës për sqarime dhe i zbërthyem të gjithë përbërjet e artikujve që përbejnë pakot qe ju i keni kërkuara kur na ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit e nuk janë bazuar as në dëshmitë e çmimeve të ETC, VIVA FRESH , Meny - Nazi Restorant, Me Luge, dhe kuponëve fiskal, kur kane vendosur me datën 10.12.2025 për refuzimin si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim të datës 08.12.2025 e as tani kur na kane refuzuar Kërkesës tone për Rishqyrtim të datës 09.03.2026.

Së çmimet me të cilat kemi ofertuar janë çmime reale të tregut e dëshmon edhe fakti që Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës me datën 15.12.2025 na ka dërguar Ftesën për negociata për të njëjtat shërbime - Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se për aktivitetin me numër të prokurimit: 214/30400-25-11240-215

Bazuar në të dhënat e publikuara në platformë , ftesa i është dërguar edhe OE tjetër që ka ofertuar në aktivitetin e mëparshëm të prokurimit më çmime për njësi me të larta së të kompanisë tone e që aktivitet që AK ka marre vendim që ta anuloi.

AK-Policia e Kosovës aktivitetin me numër të prokurimit: 214/30400-25-11240-215- Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se që, e ka zhvilluar duke përdore Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë në Specifikat Teknike dhe Listën e Përshkrimit të Çmimeve i ka hequr disa artikuj të përbërjes së Pakove:

Çokollatë kalorike-proteinike – që në dy aktivitetet kemi kalkuluar çmimin prej 1.10 €  
Lajthi dhe badem - që në dy aktivitetet kemi kalkuluar çmimin prej 2.00 €  
Kaçkavall - që në dy aktivitetet kemi kalkuluar çmimin prej 1.80 €

Me datën 17.12.2025 kemi dërguar ofertën definitive të AK, ku për disa artikuj më çmime për njësi të PAKOVE kemi ofertuar mesatarisht 2,70% më të ulëta e për disa artikuj kemi ofertuar me çmime të njëjta krahasuar me çmimet për njësi të pakove që kemi ofertuar në Procedurën e hapur me datën 24.11.2025.

Si ka mundësi që AK-PK e ka konsideruar çmime disa here me të larta së çmimet e tregut dhe ka marre vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit ndërsa në procedurën e negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontrate i ka konsideruar si çmime të tregut?

Arsyeja së në Procedurën e Negociuar pa Publikim të Njoftimit për Kontrate kemi ofertuar mesatarisht 2.7 % me lire për disa artikuj së çmimit e pakove e për disa artikuj kemi ofertuar me çmime të njëjta krahasuar me çmimet për njësi të pakove që kemi ofertuar ne Procedurën e hapur me datën 24.11.2025 është fakti së në Procedurën e Negociuar është parapare që kontrata të jete vetëm 3 muaj dhe rrisht për rritjen e çmimeve të artikujve ushqimor në treg brenda këtyre tre muajve është shume me i vogël krahasuar me rrishtun e rritjes së çmimeve të procedurës së hapur, ku kontrata është parapare që të realizohet brenda 36 muajve.

Kjo me së miri dëshmon së çmimet për njësi të Pakove që kemi ofertuar në procedurën e hapur e të cilën Autoriteti Kontraktues e ka anuluar , janë çmime reale të tregut kur merren parasysh këta faktorë:

- Rritja e vazhdueshme e çmimeve të artikujve ushqimor që përdoren për përgatitjen e ushqimeve dhe pakove që ka kërkuar AK;
- Kostot e transportit të ushqimeve në tere territorin e Republikës së Kosovës që vazhdimisht kane tendence të rritjes;
- Kostot e pagave të punëtoreve që vazhdimisht kane tendence të rritjes;
- Rrishtun i rritjes së çmimeve të artikujve ushqimor gjate realizimit 36 mujor të kontratës;
- Kostot për kamata kreditore për shkak të vonesave të pagesave të faturave nga AK-Policia e Kosovës deri në 5 muaj vonesa;
- Kostot e paketimit të ushqimeve në paketime të veçanta për transportim, kosto që nuk janë parapare në Përshkrimin e Çmimeve që mesatarisht për një muaj vetëm kostoja e tyre është mbi 4,000.00 €;
- Kosto tjera shtese të pa planifikuara gjate realizimit të kontratës për shkak të kompleksitetit të realizimit të kontratës;

Autoriteti Kontraktues gjate hulumtimit të tregut pas vendimit te OSHP-se , fare nuk i ka marre për baze këta faktorë dhe nuk ka marre për baze as pagat e të punësuarave që kryejnë shërbimet për realizimin e kontratës për Policinë e Kosovës. Bazuar në pagat e muajt **Shkurt 2026** vetëm pagat e

të punësuarve që janë duke realizuar kontratën aktuale të Policisë së Kosovës ( pa përfshi pagat e administratës dhe departamenteve tjera mbështetëse) për një muaj janë **19,991.57 €**. Kur merret për baze që kontrata për aktivitetin e prokurimit për të cilin po dërgojmë këtë ankese është planifikuar të jete **36** muaj, del së vetëm vlera totale e pagave për **36** muaj është: **719,696.50 €**. Vlera totale e parashikuar nga AK për këtë aktivitet të prokurimit është: **2,700,000.00 €**.

Pjesëmarrja e pagave të stafit që direkt është i përfshire në realizimin e kontratës ( pa përfshi pagat e administratës dhe departamenteve tjera mbështetëse) është **26.66 %**.

Në Republikën e Kosovës ka mijëra kompani që merren me ofrimin e shërbimeve të gastronomisë por për shkak së kontratat kornize afatgjata më çmime për njësi fikse (të pa ndryshuara gjate realizimit të kontratës) të nënshkuara me Autoritetet Kontraktuese janë shume komplekse dhe kane një rrisht shume të madhe pikërisht për shkak të rritjes së vazhduar të çmimeve të artikujve ushqimor në akativitete të prokurimit të publikuara nga AK ofertoje shume pak kompani.

Siç jeni të informuar në këtë aktivitet të prokurimit kane ofertuar vetëm dy Operator Ekonomik dhe të dy këta Operator Ekonomik kane një konkurrencë mes veti ku çdo here tentojnë që të ofertojnë me çmime sa me të lira për ta fituar kontratën dhe në këtë rast oferta e kompanisë tone Beni Dona Plast SH.P.K është oferta me çmim për njësi me të lire të peshuar prej vetëm **65.97 €** dhe është e vetmja oferte që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Operatori tjetër , OE: Isuf Musliu B.I ka ofertuar me çmim të peshuar prej **68.13 €** - vetëm **2.16 €** me të larte së çmimi i peshuar i ofertës tone dhe ka dorëzuar oferte të pa përgjegjshme.

Bazuar në këto çmime për njësi të këtyre dy ofertave të pranuar nga AK dëshmon së arsyetimi i Autoritetit Kontraktues së gjeja kompania jone ka ofertuar “me çmime shume here me të larta së sa çmimet reale të tregut”, **nuk qëndron**.

Sipas Formularit B58- Njoftim nga Autoriteti Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe Letrave Standarde mbi Tenderuesit e Eliminuar të publikuara nga AK me datën **27.02.2026** shihet së OE Isuf Musliu B.I, as që ka pranuar ta beje vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit.

Fatkeqësisht edhe Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave nuk ka marre për baze asnjë nga faktorët që kane ndikuar në rritjen e çmimit të pakove ushqimore gjate viteve të fundit të cilat i cekem me larte.

Bazuar në të dhënat e shënuara me larte shihet së AK- Policia e Kosovës edhe gjate rivlerësimit të ofertave ka bere shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës , konkretisht:

**Nenit 7 të LPP**, duke diskriminuar kompaninë tone Beni Dona Plast SHPK me të vetmin qellim për të na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit pasi që kemi dorëzuar ofertën me çmimin më të lire dhe kemi plotësuar të gjitha kërkesat- kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

**Nenit 59 të LPP dhe nenit 40 të RRPP Nr. 002/2024**, duke bere vlerësimin e ofertave pa u bazuar në çmimet e tregut, sqarimet që ju kemi dërguar me datën 01.12.2025 gjate fazës së vlerësimit të pare të ofertave, faktet dhe argumentet që kemi dërguar se bashku me Kërkesën për Rishqyrtim dhe duke mos marre për bazë as konstatimet e Panelit Shqyrtues në Vendimin me **Nr. OSHP/2025/1248 të datës 09.02.2026**.

**Nenit 62 të LPP dhe nenit 43 të RRPP Nr. 002/2024** duke anuluar aktivitetin e prokurimit pa u plotësuar asnjë nga kushtet e parapara në këto dy dispozita të legjislacionin të prokurimit publik, për faktin së oferta e kompanisë tone Beni Dona Plast SHPK është oferte e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Gjithashtu është oferta me çmimin me të lire në total të peshuar për njësi prej vetëm **65.97 €**.

**Nenit 97, paragrafi (h)- të Rregullores 02/2024 për Prokurimin Publik** për faktin së gjate rivlerësimit të ofertave nuk e ka zbatuar Vendimi i Panelit Shqyrtues, **OSHP/2025/1248 09.02.2026** pasi që komisioni i rivlerësimit të ofertave nuk ka vepruar sipas rekomandimeve dhe të gjeturave të Panelit Shqyrtues.

**Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP –së, që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar dhe të urdhëroje AK- Policinë e Kosovës, që të anuloj vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës **27.02.2026** dhe lenden ta ktheje në Ri-vlerësim.**

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

**Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës shume voluminoze , shpenzimet e përgatitjes së dy Kërkesave për Rishqyrtim përgatitjes së dy Ankesave për OSHP dhe fitimet e pritura.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. B05- Njoftimi për kontrate: 12.09.2025
2. B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim Gabimi:24.09.2025
3. B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim Gabimi:14.11.2025
4. Kërkesë për Rishqyrtim – Isuf Musliu B.I: 03.10.2025
5. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit: 17.09.2025
6. Vendim mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim OE: Isuf Musliu B.I: 23.09.2025
7. Ankesa në OSHP, Nr. 2025/0984 Isuf Musliu B.I : 03.10.2025
8. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit:03.10.2025
9. Raporti i Ekspertit Shqyrtues për Ekspertizën 2025/0984:15.10.2025
10. Vendimi i OSHP-se nr. OSHP: 2025/0984:
11. Kërkesë për Rishqyrtim Beni Dona Plast SH.P.K: 19.11.2025
12. Vendim mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit: 19.11.2025
13. Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim Beni Dona Plast SH.P.K: 19.11.2025
14. Procesverbali i Hapjes së Ofertave: 24.11.2025
15. B47- Letra Standarde e Kërkesë për Sqarimet e Tenderit:26.11.2025
16. Përgjigjja në kërkesën e AK për sqarime të Tenderit, Beni Dona Plast SH.P.K: 01.12.2025;
17. Raporti i Vlerësimit të ofertave: 02.12.2025
18. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 02.12.2025
19. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 02.12.2025
20. Kërkese për qasje në dokumentet e tenderit- E-Prokurimi: 03.12.2025
21. Pranimi i dokumenteve të Tenderit nga AK ne CD ne lokalet e AK- Policisë së Kosovës: 04.12.2025
22. Kërkese për Rishqyrtim: 08.12.2025
23. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 10.12.2025
24. Ankesa ne Organin Shqyrtues të Prokurimit nr. 2025/1248 :19.12.2025
25. Vendimi i Panelit Shqyrtues, OSHP/2025/1248 :09.02.2026
26. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Anulim i aktivitetit të prokurimit: 27.02.2026
27. Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që ka të shënuar datën 25.02.2026 ndërsa në Platformën e E-Prokurimit është publikuar me 27.02.2026
28. Kërkese për qasje në dokumentet e tenderit- E-Prokurimi:02.03.2026
29. Raportit i Rivlerësimit të ofertave : 03.03.2026
30. Dëshmitë e çmimeve të kompanive ETC, VIVA FRESH , Meny - Nazi Restorant, Me Luge, dhe kupon fiskal.
31. Kontratën e nënshkruar me AK-Policinë e Kosovës me numër të Prokurimit: 214/30400-25-11240-215 - Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se: 31.12.2025
32. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*